



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



KOMUNA E PRISHTINËS

KRYETARI I KOMUNËS

01. nr. 031-24768³, me 29.10.2015

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale 03/L - 040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 5, paragrafi 5.2 të Ligjit për ndërmarrjet publike 03/L - 087 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës " nr. 31/15 qershor 2008), të nenit 53 të Statusit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, me datën 29.10.2015 merr këtë

V E N D I M

**PËR CAKTIMIN E ANËTARIT NË KOMISIONIN KOMUNAL TË AKSIONARËVE
PËR NDËRMARRJEN PUBLIKE TË KOMUNALE "TRAFIKU URBAN" SH.A.**

I

Genc Bashota, CAKTOHET anëtar në komisionin komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike të Komunës së Prishtinës; "Trafiku Urban" Sh. a.

II

Anëtari i cekur në pikën I të këtij Vendimi së bashku me dy anëtarë të cilët i emëron Kuvendi i Komunës e përbëjnë komisionin komunal të aksionarëve për ndërmarrjen komunale "Trafiku Urban" Sh. a.

III

Anëtari i komisionit komunal të aksionarëve, i caktuar me këtë vendim, ka të drejtë të veprojë në emër të Kryetarit të Komunës

IV

Veprimet e anëtarit të komisionit komunal të aksionarëve duhet të jenë në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike, Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike dhe Ligjit për shoqëritë tregtare.

V

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

IU DORËZOHET:

- Anëtarit,
- Qendrës për shërbimeve me qytetar.

